



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 

1 Do e kishte spastruar etnikisht Kosovën - Gërvalla depoziton kallëzim penal për ministrin serbe: Deklaratat e saj mbartin pasoja të rëndat!
- 

2 Messi dhe Yamal, 'fati i shkruar në yje'! Realizohet profecia e një seti fotografik të bërë 19 vite më parë
- 

3 paguar 2.9 mln €?! Deputeti zero transparencë! Paralajmërohet padi në SPAK, Balla: Pastrim parash
- 

4 Kush ia bleu 15 mln euro Agron Shehajt vllan që vetëm 4 vite më herët kishte Bankën e Shqipërisë hidhet për Konsultim Publik
- 

5 Gjykata e Lartë nuk pranon rekursin e Belinda Ballukut, mbetet në fuqi masa e pezullimit nga detyra

Kronikë


Ekzekutimi i 40-vjeçarit në Shkodër, policia sekuestron 25 gëzhoja në vendin e ngjarjes! Pista e hetimit, gjakmarrja (VIDEO)

Një vrasje me armë zjarri u regjistrua mbrëmjen e së shtunës në Dukagjin të Shkodrës. Viktimë mbeti Aleksandër Koçeku, rreth 40 vjeç. Ai u qëllua disa herë me armë zjarri duke mbetur i vdekur ne vend. Koçeku po lëvizte nga Kiri i Dukagjinit drejt Prekalit për në Shkodër, ku në afërsi të fshatit Lin, u qëlluan drejt tij plot 25 plumba. Pista kryesore e hetimeve, një vrasje të vëllait të viktimës në vitin 2017.

■ I vëllai i viktimës 9 vite më parë ekzekutoi Angjelin Shkambin për një borxh e një çështje nderi



**Ergys Kavaja**
12 Korrik, 10:21 | Përditësimi: 12 Korrik, 14:43

 Share  Post 

A A

Shkodër - 25 gëzhoja automatiku, të gjitha të qëlluara nga e njëjta armë, janë sekuestruar në vendin ku u ekzekutua **Aleksandër Koçeku** në fshatin Lin, në zonën e Karmës së Kirit, përgjatë aksit Kir–**Prekal**. Ka qenë një kalimtar i rastësishëm ai që ka konstatuar automjetin me viktimën brenda dhe ka njoftuar menjëherë policinë.

Nga këqyrja e parë e grupit hetimor rezulton se autori ose autorët i kanë zënë pritë 40-vjeçarit dhe e kanë qëlluar me breshëri automatiku.

Viktima lëvizte me kujdes për shkak të gjakmarrjes dhe punonte në një furrë buke.



LEXO EDHE: I riu plagos me thikë 32-vjeçarin në Shkodër, i vëllai tenton të vrasë autorin, vihet në pranga! Në kërkim 18-vjeçari (VIDEO)

Hetuesit po administrojnë pamjet e kamerave të sigurisë përgjatë itinerarit që ai përshkoi, megjithëse në zonën ku ndodhi **atentati** nuk ka kamera, çka e vështirëson zbardhjen e ngjarjes.

Burime pranë grupit hetimor bëjnë me dije se pista kryesore ku janë përqendruar hetimet lidhet me një vrasje të mëparshme, ekzekutimin me armë zjarri të Angjelin Shkambit në dhjetor të vitit 2017.

Atëherë, vëllai i viktimës së sotme, **Artan Koçeku**, **qëlloi** Shkambin me 10 plumba, pasi e kishte thirrur në një takim.

Sipas dosjes hetimore të asaj kohe, konflikti lidhej me një borxh prej 40 mijë eurosh, por edhe me një çështje nderi, pasi viktima kishte pasur një lidhje me motrën e vëllezërve Koçeku. Artan Koçeku po vuan dënimin për atë vrasje.

Familjarë të Aleksandër Koçekut deklaruan se dyshojnë se atentati është kryer për gjakmarrje, duke e lidhur pikërisht me vrasjen e 9 viteve më parë.

Kushëriri i viktimës, Mark Koçeku u shpreh se familja e tyre janë në gjakmarrje që prej 2017 kur u vra Angjelin Shkambi dhe se viktima Aleksandër Koçeku lëvizte me kujdes nga frika e hakmarrjes.

Xh.K/E.H/Shqiptarja.com

TAG: [Prekal](#) [Artan Koçeku](#) [Aleksander Koceku](#) [Shkoder](#)

Komento

Komente

 Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës: Si e vlerësoni vendimin e PD për të bojkotuar seancat plenare?

14 Korrik, 12:01

[Të drejtë](#) [Të gabuar](#) [Nuk e di](#)

Lajme të tjera



Abuzimi me çmimet e shezlongëve, bashkia Shkodër kontrollë në plazhin e Velipojës! Penalitete për bizneset që abuzojnë

16 Korrik, 11:55



Lu gjenden në banesë 4 armë zjarri dhe municion, arrestohet 21-vjeçari në Shkodër (VIDEO)

16 Korrik, 08:53



Vrau bashkëshorten për xhelozoi, Gjykata e Shkodrës lë në burg 64-vjeçarin! Asnjë fjalë në seancë (VIDEO)

13 Korrik, 10:34



Ura e Mesit në Shkodër mahnit turistët e huaj: Vendi më i bukur në botë, me njerëzit më të mirë (VIDEO)

**Ergys Kavaja**

12 Korrik, 14:21



U quajt 'Ura e Vezirit', për nder të Mehmet Pashë Bushatit, historia e panjohur e urës së famshme që komunistët i vunë minat në '78-ën

**Ali Hasani**

12 Korrik, 09:57



Shkodër/ 40-vjeçari vritet me armë zjarri brenda automjetit! Dyshime për hakmarrje, i vëllai në 2017-ën ekzekutoi Angjelin Shkambin për një borxh dhe çështje nderi


11 Korrik, 20:02



Festa e Liqenit në Shkodër, natyrë, traditë e përvojë unike! Turistët e huaj: Shqipëria është një vend i mrekullueshëm

**Ergys Kavaja**

11 Korrik, 16:33



Vrasja në Shkodër/ U grindën për celularin, Shtjefën Ziçi e qëllloi të shoqen për shkak të xhelozisë, nuk shfaq pendesë! Kamerat e sigurisë fiksojnë momentin para krimit

**Ergys Kavaja**

10 Korrik, 11:33



Conference League/ Vllaznia përmbys 2-1 Malishevën në ndeshjen e parë, Brdaric rikthehet me humbje në Shkodër

9 Korrik, 22:15



Krim në familje në Shkodër, 62-vjeçari ekzekuton gruan me armë gjahu në derën e shtëpisë! Vihet në pranga (EMRAT+VIDEO)

9 Korrik, 13:40



Kompozitori me famë botërore Aldo Shllaku sjell në Shkodër 'magjinë' e muzikës së Hollywood-it

**Ergys Kavaja**

9 Korrik, 13:26




Shkodër/ Fermeri nga Postriba 'thur' vargun 110 metra të gjatë me qepë, e vendos në urën e Mesit (VIDEO)

**Ergys Kavaja**

8 Korrik, 14:04

 Lajmi i fundit



Tabaku: Qeveria po sakrifikon tokën bujqësore për klientët e radhës, bujqësia është në koma

16 Korrik, 16:50






RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com



× **[Sh]**
.COM Lajmi i fundit



**Tabaku: Qeveria po sakrifikon
tokën bujqësore për klientët e
radhës, bujqësia është në koma**

16 Korrik, 16:50